

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8251
E enjte, 26 shkurt 2026
Çmimi 0.50 €

OVLUÇK nis petition kombëtar në mbështetje të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MURAT JASHARI REFUZON POSTIN E PRESIDENTIT: FAMILJA JASHARI U TAKON TË GJITHË SHQIPTARËVE



Murat Jashari, në një prononcim për VOXKosova, ka refuzuar mundësinë për të marrë postin e presidentit. Ai ka theksuar se

familja Jashari "u takon gjithë shqiptarëve" dhe nuk duhet të përfshihet në kalkulime politike të zakonshme

KONJUFCA: NJË EMËR NGA FAMILJA JASHARI PËR PRESIDENT, KONSENSUS AUTOMATIK NË SHOQËRI F. 5



SPIROPALI: KOSOVA PRIORITET I POLITIKËS TONË TË JASHTME, AJO MERITON STATUSIN E VENDIT KANDIDAT NË BE F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



CONFERENCE LEAGUE, DRITA SYNON PËRMBYSJEN NDAJ CELJES F. 11



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency
Internet Website,
Marketing...

NË FJALIMIN DREJTUAR KOMBIT, TRUMP PARALAJMËRON IRANIN DHE ZOTOHET PËR PAQE NË UKRAINË

UASHINGTON, 25 SHKURT - Presidenti amerikan, Donald Trump, shfrytëzoi fjalimin më të gjatë drejtuar kombit në historinë e Shteteve të Bashkuara për të përsëritur kërcënimin për veprim ushtarak kundër Iranit nëse diplomacia dështon dhe për t'u zotuar se do të vazhdojë negociatat për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë.

Duke folur për gati 1 orë e 50 minuta, Trump përdori seancën e përbashkët të Kongresit amerikan për t'i paraqitur arritjet e administratës së tij, duke i cilësuar ato si agim i një "epoke të artë".

Fjalimi ishte një mundësi për t'u përqendruar në politikën e brendshme përpara zgjedhjeve afatmesme të nëntorit, por presidenti Trump rikonfirmoi gjithashtu prioritetet kyç në politikën e jashtme dhe sigurinë botërore.

Irani

Trump i kushtoi disa minuta Iranit, të cilin e paraqiti si kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm, duke rikujtuar po ashtu sulmet ushtarake të ShBA-së ndaj këtij shteti në qershor të vitit të kaluar. "Pas [operacionit] Çekani i Mesnatës, ata u paralajmëruan që të mos bënëin përpjekje të reja për të rindërtuar programin e tyre të armëve, veçmas të armëve bërthamore. Megjithatë, ata vazhdojnë të nisin gjithçka nga e para", tha ai. "Unë preferoj që ta zgjidh këtë problem përmes diplomacisë", tha Trump. "Por, një gjë është e sigurt: Unë kurrë nuk do të lejoj sponsorin numër një në botë të terrorit, që ata janë, të ketë armë

bërthamore. Nuk mund ta lejoj një gjë të tillë".

Këto deklarata u bënë në një kohë të grumbullimit masiv ushtarak të ShBA-së në Lindjen e Mesme, si dhe përpara rundit të ri të bisedimeve mes ShBA-së dhe Iranit, të planifikuar për 26 shkurt. Këto bisedime janë të përqendruara kryesisht në programin bërthamor të Iranit, për të cilin Teherani këmbëngul se ka qëllime paqësore dhe civile, sikurse është prodhimi i energjisë elektrike.

"Për dekada të tëra, ka qenë politikë e Shteteve të Bashkuara që të mos lejojë kurrë Iranin të ketë armë bërthamore. Për shumë dekada", tha presidenti Trump.

Duke iu referuar udhëheqjes klerikale të Iran që nga revolucionin e vitit 1979, ai tha: "Që kur morën kontrollin e atij kombi krenar 47 vjet më parë, regjimi dhe bashkëpunëtorët e tij vrasës nuk kanë përhapur asgjë tjetër veç terrorizmit, vdekjes dhe urrejtjes".

Trump shtoi se gjatë trazirave të fundit brenda Iranit, autoritetet iraniane kishin "vlarë të paktën, duket ashtu, 32.000 protestues në vendin e tyre".

Grupet e të drejtave të njeriut kanë regjistruar afër 7.000 vdekje, por besohet gjerësisht se numri real i viktimave është dukshëm më i lartë.

Trump i mbylli komentet e tij për Iranin me këtë paralajmërim: "Asnjë komb nuk duhet të dyshojë ndonjëherë në vendosmërinë e Amerikës. Ne kemi ushtrinë më të fuqishme në Tokë".

Në një reagim, që duket se është përgjigje ndaj fjalimit të Trumpit,



zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Esmail Baqaei, shkroi në rrjetet sociale se administrata amerikane po përhap gënjeshtër. "Çfarëdo që ata pretendojnë sa i përket programit bërthamor të Iranit, raketave balistike dhe numrit të viktimave gjatë trazirave të janarit thjesht janë përsëritje e 'gënjeshtrave të mëdha', shkroi ai.

Ukraina

Kësaj pjese të fjalimit të tij i paraprin komente të shkurtra për Ukrainën, ku pushtimi rus i Ukrainës tashmë ka hyrë në vitin e pestë.

Trump tha se administrata e tij po "punon shumë fort" për t'i dhënë fund luftës, duke iu referuar bisedimeve disamujore që vazhduan edhe javën e kaluar me takime trepalëshe në Gjenevë të Zvicrës.

I dërguari i tij kryesor, Steve Witkoff, ishte i pranishëm. Ai tha pas rundit të fundit të bisedimeve se ishte arritur "përparim domethënës", pa dhënë detaje, duke shtuar se "të

dyja palët janë pajtuar që të vazhdojnë punën drejt një marrëveshjeje".

Në fjalimin e tij, Trump nuk përmendi detaje, por sërish e ktheu vëmendjen te kostoja e tmerrshme njerëzore e konfliktit. "Njëzet e pesë mijë ushtarë po vdesin çdo muaj. Mendoni për këtë: 25.000 ushtarë në muaj", tha ai.

Shifrat e viktimave nuk janë publike dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur. Megjithatë, një raport i fundit vlerëson se numri i të vrarëve, plagosurve dhe të zhdukurve është afër 1.2 milion në anën e Rusisë dhe 500-600 mijë në Ukrainë.

Duke përsëritur një pretendim të dëgjuar edhe në fushatë zgjedhore, Trump shtoi se lufta "nuk do të kishte ndodhur kurrë nëse unë do të isha president".

Deklarimet e tij vijnë në kohën kur udhëheqësit evropianë e shfrytëzuan përvjetorin e katërt të nisjes së luftës për të përsëritur mbështetjen e tyre për Kievin dhe në kohën kur ka pikëpyetje lidhur me strategjinë afatgjatë të Uashingtonit.

Energjia, tarifat

Politika e jashtme ishte e lidhur ngushtë me agjendën e brendshme ekonomike të presidentit Trump.

Ai vuri në pah zgjerimin e prodhimit të naftës dhe gazit nën politikën e tij, duke argumentuar se rritja e prodhimit në ShBA së bashku me atë që e përshkroi si një "fillim të mbarë" në Venezuelë - do të ndihmojë në uljen e çmimeve botërore të energjisë.

Duke e quajtur Venezuelën "miken dhe partneren tonë të re", Trump tha se ShBA-ja kishte siguruar 80 milionë fuçi nafte pas rrëzimit nga pushteti të liderit të kamotshëm, Nicolas Maduro.

Sa i përket tregtisë, Trump tha se tarifat që janë paguar nga shtetet e huaja në fund "do të zëvendësojnë sistemin modern të tatimit mbi të ardhurat", duke shtuar se ato do të lehtësojnë barrën financiare për amerikanët. Gjatë gjithë adresimit drejtuar kombit, Trump u rikthye vazhdimisht te një temë qendrore: rimëkëmbja amerikane.

Teksa fjalimi i Trumpit u prit me duartrokitje dhe ovacione nga republikanët, demokratët qëndruan të ulur. Dhjetëra prej tyre e bojkotuan krejtësisht këtë ngjarje, duke mbajtur një ngjarje të veçantë në një vend tjetër në Uashington, ku kritikuan Trumpin për një sërë çështjesh. "Nuk jam në adresimin drejtuar kombit sonte, sepse këto nuk janë kohëra normale dhe demokratët duhet të ndalojnë së vepruari në mënyrë normale", tha senatori demokrat Chris Murphy.

KE-ja PROPOZON HEQJEN E ROAMING-ut PËR VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

STRASBURG, 25 SHKURT - Komisioni Evropian (KE) ka propozuar nisjen e negociatave me gjashtë vendet e Ballkani Perëndimor për t'i përfshirë ato në regjimin e Bashkimi Evropian "Roam Like at Home" (Pa tarifa shtesë).

Programi i Komisionit Evropian "Roam Like at Home" është një rregullore e BE-së që u mundëson përdoruesve të telefonisë mobile të përdorin telefonat e tyre në shtetet e tjera anëtare me të njëjtat çmime si në vendin e tyre.

Kjo do të thotë se gjatë përdorimit të telefonit mobil në zonën e Bashkimi Evropian nuk ka kosto shtesë roaming-u për thirrjet, mesazhet SMS dhe përdorimin e internetit.

Komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, vlerësoi se kostot e roaming-ut paraqesin problem për qytetarët në shtetet e Ballkanit Perëndimor. "Tarifat e roaming-ut janë problem në gjithë Ballkanin Perëndimor. Për punëtorët që punojnë jashtë vendit dhe familjet që telefonojnë më të dashurit e tyre jashtë vendit. Faturat e papritura kur udhëtoni janë diçka që ne më nuk e pranojmë në BE. Sot propozojmë nisjen e bisedimeve për ta përfshirë në këtë edhe Ballkanin Perëndimor", shkroi Kos në "X".

Me propozimin për nisjen e bisedimeve, Komisioni Evropian kërkon miratimin e Këshilli i BE-së për hapjen e negociatave me

partnerët nga Ballkani Perëndimor. Pasi Këshilli ta miratojë këtë kërkesë, Komisioni Evropian do të negociojë marrëveshje dypalëshe me secilin shtet të rajonit.

Pasi marrëveshjet për këtë çështje të përmbyllen me sukses, ato do të hapin rrugën që Ballkani Perëndimor të bëhet pjesë e zonës "Roam Like at Home" në BE.

Pas finalizimit të marrëveshjeve dhe harmonizimit të plotë me rregullat e BE-së për roaming-un, qytetarët që udhëtojnë mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor do të mund të realizojnë thirrje, të dërgojnë mesazhe dhe të përdorin shërbime të internetit, pa tarifa shtesë të roaming-ut.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KONJUFCA: NJË EMËR NGA FAMILJA JASHARI PËR PRESIDENT, KONSENSUS AUTOMATIK NË SHOQËRI

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka thënë të mërkurën se nëse do të vinte një emër për president nga familja e heroit të Kosovës, Adem Jashari, do të ishte një “konsensus automatik” në shoqëri. Ai ka theksuar se shumica aktuale ka 66 vota në Kuvend dhe për arritjen e 80 votave të kërkuara për president duhet edhe mbështetja e partive opozitare. Sipas tij, 80 vota nuk mund të arrihen nëse propozohet një “emër i njëanshëm”

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca, tha se nëse do të vinte një emër për president nga familja e heroit të Kosovës, Adem Jashari, do të ishte një “konsensus automatik” në shoqëri. “Konsensus të partive politike, deri tash të vetmit emra që kanë shkaktuar automatikisht një pritje pozitive, një konsensus automatik në shoqërinë tonë është një president nga radhët e familjes së nderuar Jashari”, ka thënë ai për mediat më 25 shkurt, pas takimit me kryediplomaten e Shqipërisë, Elisa Spiropali.

I pyetur se a ka vullnet nga familja Jashari për këtë çështje, Konjufca tha se nuk i takon të flasë në emër të tyre. “Duhet të shkoni atje dhe ta merrni përgjigjen, nuk jam unë këtu që të supozoj se kjo është. Ka qenë kryeministri aty”, ka thënë ai.

Ditë më parë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qëndruar në Prekaz të Skenderajt te familja Jashari.

Ai ka konfirmuar për mediat se ka biseduar me Rifat Jasharin “për çështje politike”.

Emra nga kjo familje, në të kaluarën, janë përmendur si kandidatë potencialë për president, por asnjë prej tyre nuk ka përfunduar në propozim zyrtar.

Për çështjen e presidentit, Konjufca u pyet edhe gjatë një konference për media me homologen nga Shqipëria, Elisa Spiropali.

Ai i cilësoi si pozitive takimet që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh kryetar i Lëvizjes

Vetëvendosje, ka zhvilluar me krerët e dy partive më të mëdha opozitare, Bedri Hamzën e Partisë Demokratike të Kosovës, dhe Lumir Abdixhikun e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në përpjekje për të gjetur një zgjidhje për çështjen e kreut të ri të shtetit. Konjufca ka deklaruar se hartuesit e Kushtetutës e kanë shkruar pjesën për zgjedhjen e presidentit me idenë që një shumicë e thjeshtë të mos ketë garancinë që ta zgjedhë vetë atë, por kjo të ndodhë në bashkëpunim me forcat politike. Ai ka thënë se shumica aktuale ka 66 vota në Kuvend dhe për arritjen e 80 votave të kërkuara për president duhet edhe mbështetja e partive opozitare. Sipas tij, 80 vota nuk mund të arrihen nëse propozohet një “emër i njëanshëm”. “Pra, konkludimi është që përmes një emri të përveçëm ne mos ta mbështesim për muri opozitën”, ka thënë ai.

Vetë Kurti ka kërkuar një marrëveshje me PDK-në dhe LDK-në për presidentin, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e parakohshme. Nga PDK-ja kanë thënë se nuk do të jenë pengesë e proceseve shtetërore, por nuk mbështetin kandidatura që nuk përfaqësojnë unitet qytetar, ndërkaq LDK-ja ka kërkuar ose marrëveshje politike ose konsensus për kreun e ri të shtetit.

Derisa kanë mbetur edhe gjashtë ditë pune nga afati kushtetues për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, por në vend të emrave dhe marrëveshjeve konkrete, dominon paqartësia.

Në prapaskenë, procesi nuk duket të jetë vetëm një detyrim

formal kushtetues, por pjesë e një kalkulimi më të gjerë politik të kryeministrit Albin Kurti. “Kurti synon një president që do të jetë nën kontrollin e tij në momentet e rëndësishme politike”, ka thënë për Radion Evropa e Lirë Imer Mushkolaj, njohës i zhvillimeve në Kosovë.

Ai vlerëson se veprimtaria diplomatike e presidentes aktuale, Vjosa Osmani, i pengon llogaritjet e Kurtit, ndaj është në kërkim të një emri të ri. “Unë mendoj se Kurti mund ta ketë një emër që do ta propozojë, me shpresën që edhe opozita ta mbështesë. Nuk e di nëse ky emër do të vijë nga familja Jashari”, ka deklaruar Mushkolaj, duke shtuar se i gjithë procesi po zhvillohet me një mungesë shqetësuese të transparencës.

Sipas Mushkolajt, mesazhet publike të Kurtit lënë të kuptohet se mund të hiqet dorë nga mundësia që Osmani të fitojë një mandat të ri. Por, ai paralajmëron se nëse Vetëvendosja dhe opozita nuk gjejnë një emër të përbashkët, ajo mund të rikthehet si kandidate, për të shmangur zgjedhjet e reja. “Për të evituar zgjedhjet e parakohshme, nuk përjashtohet që zonja Osmani të jetë sërish në lojë”, vlerëson Mushkolaj. “Por, thellë-thellë, unë besoj që Kurti është i interesuar për një person që nuk ia prish matematikat”, ka shtuar ai.

Deputetët e Kosovës kanë afat deri më 4 mars që të zgjedhin presidentin e ri, pasi presidentes aktuale, Vjosa Osmani, i skadon mandati pesëvjeçar më 4 prill. Osmani ka shprehur synimin edhe për një mandat të dytë në krye të shtetit.

MURAT JASHARI REFUZON POSTIN E PRESIDENTIT: FAMILJA JASHARI U TAKON TË GJITHË SHQIPTARËVE

Murat Jashari, në një prononcim për VOXKosova, ka refuzuar mundësinë për të marrë postin e presidentit. Ai ka theksuar se familja Jashari “u takon gjithë shqiptarëve” dhe nuk duhet të përfshihet në kalkulime politike të zakonshme



PRISHTINË, 25 SHKURT - Murat Jashari, djali i Rifat Jasharit, në një intervistë ekskluzive për VOX Kosova ka thënë se nuk është i interesuar të bëhet president i Kosovës, edhe pse emri i tij u përfol këto ditë nga qarqe politike, meqë më 4 prill i përfundon mandati presidentes Vjosa Osmani, derisa i riu duhet të zgjidhet më së largu deri më 4 mars.

“Partitë po shprehin gatishmërinë e tyre, ato po shpresojnë në këtë çështje. Unë i falënderoj që na besojnë ose më besojnë për pozita të tilla. Por ua kam bërë të qartë se cilat janë arsyet pse unë nuk e bëj, sepse mbi supet e mia rëndon një barrë e madhe”, tha Jashari. Ai ka theksuar se këtë pozitë do ta pranonte vetëm në gjendje të jashtëzakonshme, teksa ka shtuar se gjithmonë është i gatshëm, nëse është nevoja të sakrifkohet për vendin.

“Vetëm në gjendje të jashtëzakonshme, ruana Zot ndonjë luftë civile, ndonjë

rrezik i madh kombëtar ku cenohet bërthama e kombit tonë dhe e vendit tonë, atëherë kush jam unë të mos sakrifikohem për këtë vend? Pra, unë jam gjithmonë i gatshëm, me gjithë fëmijët që mi ka falë Zoti, të sakrifikohem për këtë vend. Ama jo ta keqpërdor emrin e familjes Jashari për pozita personale. Këto duhet t'i kuptojë opinioni i gjerë”, potencoi ai.

“Mes të qenit në pozita publike dhe profesionit që kam, si dhe pjesës së familjes që jam, unë i zgjedh këto të fundit. Partitë politike, ose politika nëse e përkthejmë me gjuhën tonë të bukur shqipe, i bie menaxhim i punëve publike. Pra, ata që dalin në zgjedhje e kanë për obligim, sepse marrin besimin dhe taksat e qytetarëve. Në politikë jemi për t'i menaxhuar këto dy gjëra dhe ata duhet të gjejnë zgjidhje për këtë punë, sepse e kanë besimin dhe taksat e qytetarëve”, shtoi Jashari.

OVLUÇK nis petition kombëtar në mbështetje të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së kanë njoftuar se kanë nisur një petition kombëtar drejtuar Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. Sipas OVLUÇK-së, ky petition është

një thirrje e hapur qytetare në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të ish-krerëve të saj që po përballen me procesin në Hagë, në mbrojtje të vlerave të luftës sonë çlirimtare dhe të

dinjitetit të saj. “Ftojme të gjithë qytetarët dhe bashkëkombësit kudo që ndodhen që t'i bashkohen këtij peticioni, ta nënshkruajnë dhe ta shpërndajnë atë”, ka njoftuar OVLUÇK-ja.





SPIROPALI: KOSOVA PRIORITET I POLITIKËS TONË TË JASHTME, AJO MERITON STATUSIN E VENDIT KANDIDAT NË BE

“Kosova është prioritet absolut i politikës së jashtme të Shqipërisë, por e lidhur shumë ngushtësisht me të gjitha zhvillimet e brendshme në Shqipëri dhe Kosovë. Kjo nuk është retorikë sovraniteti e as formulë diplomatike, por është orientim strategjik i qëndrueshëm shtetëror. Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës është interes kombëtar i drejtpërdrejtë i Shqipërisë, përveç se është dëshirë e jonë e zemrës”, kështu ka thënë të mërkurën në Prishtinë ministrja për Evropë dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Elisa Spiropali

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministrja për Evropë dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Elisa Spiropali, ka thënë se Kosova mbetet prioritet i politikës së jashtme të shtetit të saj, duke shtuar se beson se Kosova duhet të marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në vizitën e saj të parë në Kosovë që nga formimi i ekzekutivit të ri, Spiropali ka

deklaruar pas takimit me homologun e saj Glauk Konjufca, se ky vit duhet të jetë viti i konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. “Kosova është prioritet absolut i politikës së jashtme të Shqipërisë, por e lidhur shumë ngushtësisht me të gjitha zhvillimet e brendshme në Shqipëri dhe Kosovë. Kjo nuk është retorikë sovraniteti e as formulë diplomatike, por është orientim strategjik i qëndrueshëm shtetëror. Forcimi i subjektivitetit

ndërkombëtar të Kosovës është interes kombëtar i drejtpërdrejtë i Shqipërisë, përveç se është dëshirë e jonë e zemrës”, ka thënë Spiropali. Sipas saj, siguria e Kosovës është siguri edhe për Shqipërinë, duke premtuar mbështetje për Prishtinën në rrugën e saj evropiane dhe në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, përfshirë në Këshillin e Evropës. Teksa i përshkroi si intensive 15 muajt e negociatave për hapjen e kapitujve për anëtarësim në BE, Spiropali

tha se Kosova po ashtu meriton të ketë një rrugë të qartë drejt bllokut. “Ne besojmë që Kosova duhet të marrë statusin e vendit kandidat dhe politika e zgjerimit e BE-së duhet të përdoret si një armë e fuqishme gjeostrategjike e BE-së për të mos lejuar që Ballkani Perëndimor të influencohet nga forca malinje, apo të ndikohet në procese që nuk i shërbejnë paqes dhe stabilitetit”, është shprehur Spiropali.

Kosova, që ka aplikuar për anëtarësim në BE në fund të vitit 2022, është i vetmi shtet në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka statusin e vendit kandidat, teksa Shqipëria ka përparuar në rrugën evropiane, duke hapur të gjithë kapitujt negociues dhe tani pret që të nisë mbylljen e tyre. Ndërkaq, ministri i Jashtëm i Kosovës, Glauk Konjufca, ka falënderuar Shqipërinë për

mbështetjen në shtetndërtim por edhe për përfaqësimin e interesit “të Kosovës në arenën ndërkombëtare, përfshirë edhe përpjekjet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. “Sa më i fort që të jetë koordinimi ynë aq më e sigurt do të jetë rruga jonë drejt BE-së”, ka thënë ai.

Kryediplomatja shqiptare, Elisa Spiropali, përsëriti qëndrimin se shteti i saj mbështet dialogun për normalizim të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë - që ndërmjetësohet nga BE-ja - dhe tha se epilogu i procesit duhet të përfshijë njohjen e ndërsjellë. “Njohja reciproke është e vetmja bazë e qëndrueshme për një marrëdhënie të shëndoshë mes dy shteteve dhe në rajonin tonë të lirë nga tensionet e trashëguara. Serbia duhet të pajtohet me këtë realitet, jo si akt presioni, por si hap të

STËRVITJA SHQIPËRI - KOSOVË - KROACI, VENGU: PANIKU I BEOGRADIT I PAJUSTIFIKUAR

TIRANË, 25 SHKURT - Një panik të pajustificuar të Beogradit e ka konsideruar ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Pirro Vengu, reagimin e institucioneve atje, pas stërvitjes së përbashkët Shqipëri-Kosovë-Kroaci. “I ndjekim reagimet, një lloj paniku i pajustificuar nga institucionet në Beograd. Ne vijojmë punën tonë. Bashkëpunimi trilateral është në zbatim e sipër. Bëmë një takim me homologët e mbrojtjes në Mynih, për të përcaktuar hapat e tjerë për prokurimet në fushën e mbrojtjes, të tre vendet kanë nevojë të ngjashme fuqizohemi duke u bërë bashkë, për kontrata më të mira më të lira. Bashkëpunimi në fushën e

industrisë, kemi një përfshirje edhe në panaiet që po organizojnë kolegët kroatë. Dhe nga ana tjetër edhe elementë stërvitorë të forcave tona. Nuk kemi pasur komunikim me Beogradin përveç faktit që ftesa është për të gjithë vendet e rajonit, fatkeqësisht ata kanë zbatuar një politikë të karriges boshe”, ka theksuar Vengu. Më 18 mars 2025, Shqipëria, Kosova dhe Kroacia kishin nënshkruar një deklaratë të përbashkët, në të cilën kanë rikonfirmuar marrëdhëniet e forta dhe të qëndrueshme, të bazuara në vlerat e përbashkëta, orientimet strategjike dhe angazhimet reciproke drejt sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal. Duke riafirmuar synimin e tyre për



të forcuar bashkëpunimin trepalësh të sigurisë dhe mbrojtjes për të rritur sigurinë dhe stabilitetin në Evropën Juglindore dhe në

rajonin Adriatiko-Jonian dhe po ashtu duke theksuar rëndësinë e përpjekjeve të përbashkëta për t’iu përgjigjur sfidave të reja të

sigurisë, kërcënimeve hibride dhe rreziqeve të tjera që mund të dëmtojnë stabilitetin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar.

SECURIMETER 2025: KOSOVA E PARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR PËR SIGURINË

PRISHTINË, 25 SHKURT - Sipas raportit më të fundit SecuriMeter 2025, Kosova renditet si vendi me perceptimin më të lartë të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, i publikuar nga Regional Cooperation Council. Sipas të dhënave zyrtare të anketës rajonale, 64% e qytetarëve në Kosovë deklarojnë se ndihen “shumë të sigurt” ose “mjaft të sigurt” në jetën e tyre të përditshme, duke shënuar përqindjen më të lartë në mesin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Vetëm rreth 16 - 17% e të anketuarve shprehën se ndihen të pasigurt, që është ndër nivelet më të ulëta në rajon. Raporti tregon gjithashtu se 58.4% e qytetarëve pajtohen se Kosova është vend i sigurt për të jetuar, ndërsa 16.8% nuk pajtohen me këtë vlerësim dhe 23.8% mbajnë qëndrim neutral. Këto shifra e pozicionojnë



Kosovën në vendin e parë në rajon për perceptimin e sigurisë së brendshme. Sa i përket sigurisë në nivel rajonal, 43% e qytetarëve të Kosovës konsiderojnë se Ballkani Perëndimor është rajon

i sigurt për të jetuar, ndërsa 21.9% mendojnë të kundërtën dhe 33.3% janë neutralë. Edhe në aspektin e së ardhmes, qytetarët e Kosovës rezultojnë më optimistë krahasuar me vendet tjera të rajonit. 36.9%

presin që situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor të përmirësohet gjatë 12 muajve të ardhshëm, ndërsa vetëm rreth 15 - 16% presin përkeqësim. Pjesa më e madhe e qytetarëve në Kosovë shprehin gjithashtu

shqetësim të ulët për mundësinë e një lufte që do të përfshinte vendin, me mbi 70% që deklarojnë se janë “pak” ose “aspak” të shqetësuar. Sipas gjetjeve të raportit, Kosova shënon gjithashtu nivelin më të ulët të shqetësimit për konflikt të brendshëm apo luftë mes vendeve të rajonit, krahasuar me shtetet tjera të WB6. SecuriMeter 2025 është realizuar gjatë periudhës maj - qershor 2025 me 6007 të anketuar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, duke analizuar perceptimet për sigurinë, stabilitetin, besimin në institucione dhe sfidat ekonomike e sociale. Gjetjet e këtij viti tregojnë se, pavarësisht sfidave globale dhe tensioneve ndërkombëtare, Kosova kryeson në rajon për ndjenjën e sigurisë dhe stabilitetit të perceptuar nga qytetarët./teve1.info/

domosdoshëm për normalizim të vërtetë”, ka theksuar Spiropali, duke shtuar se një marrëveshje përfundimtare do të duhet t’i hapë rrugën Kosovës për anëtarësim të plotë në Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera. Gjatë konferencës për medie, Spiropali foli edhe për procesin gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës ndaj katërsheve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo ka thënë se Shqipëria nuk ndërhyt në drejtësinë ndërkombëtare, por “drejtësia duhet të jetë e paanshme dhe e

shkëputur nga çdo lexim kolektiv. Drejtësia nuk mund të ecë me standarde të dyfishta, nuk mund të prodhojë perceptimin se viktimat dhe agresori vendosen në të njëjtin plan ligjor, moral dhe historik”. Gjatë qëndrimit në Kosovë, Spiropali është takuar edhe me presidenten Vjosa Osmani, kryetaren e Kuvendit, Albulena Haxhiu dhe kryeministrin Albin Kurti. Presidentja Osmani ka falënderuar Spiropalin për mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë për Kosovën dhe ka riafirmuar se marrëdhëniet e dy

vendeve janë jo vetëm vëllazërore, por edhe strategjike, të natyrshme dhe të pazëvendësueshme. “Kosova dhe Shqipëria mbeten më të forta kur veprojnë së bashku për interesat tona shtetërore, për paqen dhe për një të ardhme më të sigurt në rajon dhe më gjerë”, ka thënë Osmani. Kryeparlamentarja Haxhiu ka thënë se ishte kënaqësi të mirëpriste në takim ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Elisa Spiropali. “Shkëmbyem mendime mbi bashkëpunimin e

ngushtë mes dy vendeve dhe rolin e rëndësishëm të institucioneve tona në avancimin e interesave të përbashkëta. Bashkëpunimi dhe përkrahja e ndërsjellë mbeten qendrore për zhvillimin tonë të përbashkët dhe për mirëqenien e qytetarëve tanë”, ka theksuar Haxhiu pas takimit. Spiropali pas takimit me kryeministrin Kurti ka theksuar se diskutuan për projekte që nuk janë simbolike, por transformuese: hekurudha kuq e zi, korridoret energjetike, thellimi i bashkëpunimit në arsim, kulturë, siguri,

diplomaci dhe në çdo fushë me interes të përbashkët. “Mbledhja e përbashkët e qeverive Rama-Kurti, me projekte konkrete, me afate dhe me përgjegjësi të qarta, është hapi i radhës i bashkëpunimit. Shqipëria do të qëndrojë përkrah Kosovës jo vetëm me solidaritet, por me angazhim të përditshëm dhe vizion afatgjatë”, ka thënë Spiropali. Po ashtu, ajo ka vizituar familjen e heroit kombëtar të Kosovës, Adem Jashari, në Prekaz, ku është pritur nga Rifat Jashari.

SAMURAI RAMA DHE ‘GEISHA’ OSMANI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Bashkëdyzim i mashtrimit: Presidentja në ikje, shpresoj pakthyeshtëm, Vjosa Osmani i ndezi motorët edhe për një mandat duke shfrytëzuar të gjitha levat vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Duke përdorur tërë arsenalin në një luftë të cilën mendoi se e ka fituar pa hyrë fare në fushën e betejës. Brenda Kosovës nuk kishte fare kundërshtarë, ashtu i bënte llogaritë kjo, partia të cilën e masakroi duke e ndarë në dysh, LDK-në ende ia mbante zhagun hiç disave me karakter dhe dinjitet. Nëse dikush ka merita që Kurthi e bëri Kosovën pronë private janë krahun i luftës dhe Vjosa Osmani. Tash, promotorët dhe katalizatorët e fitoreve të Kurthit brutalisht po shkelen pikërisht nga Kurthi, i “biri” i tyre besëprerë. Vjosa Osmani ka bërë shumë mëkate në përpjekje për të siguruar edhe mandatin e dytë. Ka besuar se si rrogëtare besnike e Kurthit, e ka bekimin e “Babës” sikur që ka qenë e sigurt se edhe LDK-ja e masakruar pikërisht nga Osmani do të qëndrojë në sallë për të kaluar në raundin e tretë, sikur kur e fitoi mandatin e parë. Për votat e Listës Serbe, me plotë të drejtë është mbështetur te Mimoza Kusari duke e ditur afërsinë e saj me LS-në dhe zemlakun Milan Radoičiq. Simulimi i “paduegjëshmërisë” së Vjosa Osmanit ndaj autokratit Kurthi duke e ngritur zërin disa oktava e që nuk i durojnë veshët e Kurthit, në fakt ishte një shantazh drejtuar Kurthit dhe zhurmues ndaj reagimit të një pjese të publikut për anshmërinë dhe vartësinë patologjike të saj ndaj Kurthit. Harroi se Kurthi e ka çelësin kryesor dhe të vetëm të derës për të hyrë në Zyre të Presidentit. Në mandatin e parë Vjosa Osmani e ka përdorur çelësin rezervë. Vjosa Osmani ia ka plotësuar të gjitha kërkesat e Kurthit duke qenë pjesë aktive e

keqpërdorimeve zgjedhore të Kurthit. Duke e caktuar 28 dhjetorin ditë dhe datë për zgjedhje. Mendoi se kjo do të ishte vota kryesore edhe për një mandat tjetër. Duket se gaboi. Nëse në vitin 2021 i duhej Vjosa për vota pasi e përgjysmoi LDK-në tash nuk ka asnjë nevojë për të. Presidentja në ikje është pa parti, nuk ka guxim as të kthehet në “Guxo”, kthimi eventual në LDK-në është kthimi në vendin e krimi, nuk mund të kacavirret më për Albinin prandaj është drejt zhdukjes politike. Edhe e ka merituar, pa asnjë dyshim. Tash është në mëshirën e Kurthit dhe vetëm të Kurthit. A do të mëshirohet Kurthi? Hiç dhe asnjëherë sidomos nëse vlerëson se dikush “ia shkelë këmbën ..”. Qoftë edhe pa qëllim! Dikush mund të thotë se do të ketë luftë midis dy titanëve, unë them se është shkurorëzim midis dy mashtruesve dhe dy të pabesëve. Gjatë rrugëtimit të tyre karrierist, nuk kanë lënë kënd pa e mashtruar dhe pa e prerë në besë! Prandaj fundin nuk e kanë, as të mirë, as të ndershëm e as dinjitoz.

Aleatët pa vota: Kur Vjosa Osmani e nuhati se po treten mundësitë e përkrahjes nga Albin Kurthi, iku te Rama, Edvin Rama ku kërkoi krahun për të qarë dhe litarin e shpëtimit. Rama gënjeu publikisht se Vjosa Osmani ka qenë e rrezikuar nga hetues të Gjykatës Speciale Raciste që qenkan përpjekur, sipas Ramës pa sukses, të marrin materiale nga Zyra e saj. Krejt e pavërtetë; hetuesit ishin aty duke e bërë punën e tyre të ndyrë. Madje, u ftuan ndërkombëtarët që të sigurohej objekti për të pamundësuar largimin apo asgjësimin e ndonjë materiali që do ta ndihmonte Presidentin Thaçi. E tash patriotë, përkrahëse e UÇK-së, në ballë të protestave. Sa të mjerë jemi, sa shpejt e harrojmë të kaluarën

edhe kur e prekim me hundë! Rama u bë samuraj i “geishës” Osmani duke e detyruar Donald Trampin ta thërras Vjosën në “Bordin e Paqes” ndërmarrje personale dhe familjare e Trampit për të bërë biznes në kurriz të fatkeqësive të të tjerëve. Pastaj Vjosa Osmani iku në Amerikë në takimin e parë të Bordit të Paqes duke kapur çdo mundësi kontakti me Trampin dhe të tjerët për të dëshmuar se është njeri i amerikanëve dhe se pa të e pati puna jonë! Si xhoker e kishte takimin me Rubion dhe përrallën se me Trampin paska biseduar për gjykimin e padrejtë në Hagë! Dhe se paskan marrë garanci të forta nga Trampi. Rrenë mbi rrenë, Trampi nuk ka treguar kurrfarë interesimi për Hagën! Luftën me Jack Smith, ish kryeprokuror e ka personale e jo se ai i ka dhunuar të drejtat e njeriut Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe Salih Mustafës. Në fund, kryeprokurorja dhe kryetari i trupit gjykues janë amerikanë, janë pjesë e këtij procesi të montuar politik! Sa për Albin Kurthin, Vjosa Osmanin, Glauk Konjufcën, Albulena Haxhiun dhe Shvarc Donikën, po të vendosnin këta, kryeprokurorja West dhe kryegjykatësi Smith do të dukeshin të mëshirshëm! Këta që i përmenda shiten si pjesa patriotike e LV-së, thirren në UÇK - në kur kanë nevojë, bëjnë homazhe dhe deklarohen sikur të ishin pjesë e familjes Jashari! Kohë pa Etos është titulli i publikimit të Besim Baraliut, i burgosur politik dhe ushtar i UÇK-së që e promovon më 26 shkurt, nesër në Prishtinë, në ditëlindjen e Abetares së Lirisë dhe Bashkimit Kombëtar, të Amshueshmit Bacë Adem Demaçit. Ky titull më së shumti iu përshtatet patriotëve të remë që i kanë kapur majat e pushtetit duke ia shkundur themelet

shtetit!

Loja e presidentit: Përkundër akrobacioneve të Vjosa Osmanit duket se LV-ja nuk ia bënë votat. Ata që Vjosa Osmani u përpoq t'i përdorë edhe për një mandat nuk janë deputetë të Kosovës, janë amerikanë dhe të tjerë që nuk kanë të drejtë vote. Gjëja e fundit me të cilën do të merret Trampi është nëse Vjosa Osmani do ta fitojë edhe një mandat. Amerikanët dhe vendimmarrësit bisedojnë me ata që kanë pushtet, Vjosa nuk ka kurrfarë pushteti, madje as pushtet moral.

Albin Kurthi nuk po tregon vullnet ta rikandidojë Vjosa Osmanin edhe për një mandat. Tash i është rikthyer familjes Jashari. Edhe në vitin 2021 pati deklaruar se: “ka ardhur koha ta kemi një president nga familja Jashari..” Dhe, e bëri ...Vjosa Osmanin! Tash, shkon në 12 të natës në Prekaz me bisedua për politikë meRifat Jasharin. Paraprakisht takohet me Bedri Hamzën dhe Lumir Abdixhikun për “konsultime” për presidentin. Nuk e kam të qartë çka kërkojnë aty Hamza dhe Abdixhiku kur Kurthi as që e merr parasysh mendimin e tyre! Nuk është hera e parë që familjen Jashari e fusin në lojë e manipulimit për përfitime politike. Murat Jasharin e futën në lojë për Avokat të Popullit për ta larguar nga gara për president. As nuk u bë Avokat i Popullit as president. Në vitin 2021 përsëri u përfol Murat Jashari për president. Nuk e bënë. Tash përsëri po përfolët emri i Murat Jasharit për president. Ose do të jetë: “e treta, e vërteta, ose mashtrimi i radhës..”. Familja Jashari duhet t'i përballojë këtij tundimi nëse nuk dëshiron të jetë pjesë e mashtrimit! Statusi i tyre duhet të jetë mbi çdo parti, mbi çdo përcaktim dhe anim politik, duhet ta ruajnë shenjtërinë e të rënëve që u

hyjnizuan dhe do të bashkëjetojnë për aq kohë sa do të ketë shqiptarë dhe shqiptari! Mision i vështirë por jo edhe i pamundur!

Nëse bëhen pjesë e manipulimit dhe interesit politik do të jenë humbësit më të mëdhenj. Albin Kurthi dhe LV-ja nuk i respektojnë as të burgosurit politikë e as luftën e lavdishme të UÇK-së. Sigurisht as familjen Jashari dhe familjet tjera kombëtare dhe sakrifikuese. Po të ishte kështu nuk do ta mbillnin pjellën serbe dhe antikombëtare në të gjitha poret e pushtetit, thuaja e tërë qeveria, me shumë pak përjashtime është e tillë. Hiç nja 5 deputetëve, më gjeni ndonjë tjetër që iu vije era kombëtare! Prandaj është pafytyrësi të manipulohet me familjen Jashari! Njeriu i përgjegjshëm nuk bëhet pjesë e këtij manipulimi, as edhe duke votuar!

Albin Kurthi e ka të qartë se nuk ka rrugë tjetër përveç zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe aneksit të Ohrit që e federalizon Kosovën duke siguruar autonomi politike dhe territoriale përmes vetmenaxhimit që është shumë më i rrezikshëm se Zajebnica. Për këtë i duhet një rrufepritës, një autoritet i pakundërshtueshëm që do ta përdorë si Irone Dome - Mburoja e Hekurt e që mendon të jetë familja Jashari. Për këtë arsye ka “zbutur” qasjen ndaj opozitës. Kurthi me e ushtruar pushtetin absolut kurse gjatë marrjes së “vendimeve të vështira” përgjegjësinë ta ndajë me opozitën! Deti atëherë argëtohuni me të qenit anëtar i Bordit të Paqes në të cilin 80 për qind të anëtarëve janë kundër paqes dhe vende autoritare! Gjithashtu, krenohuni që FSK-ja po dërgohet në Gaza në mision paqësor kur edhe vet Kosova varet prej një misioni paqësor të Kombeve të Bashkuara! Çfarë paradoksi!

BDI-ja: Fillkovi e barazon gjuhën shqipe me zero, VLEN hesht

SHKUP, 25 SHKURT - Bashkimi Demokratik për Integrim shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë ndaj deklaratave dhe veprimeve të Ministrit të Drejtësisë, Igor Fillkov, i cili me qasjen e tij të fundit po e barazon gjuhën shqipe me zero në institucionet e shtetit. Përpjekja për ta përjashtuar

shqipen nga provimi i jurisprudencës, për ta minuar përdorimin e saj dhe për ta trajtuar si çështje të mbyllur, nuk është vetëm shkelje e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, por është goditje e drejtpërdrejtë ndaj Marrëveshjes së Ohrit dhe rendit kushtetues të vendit. “Gjuha shqipe është kategori kushtetuese, është kategori

ligjore, e drejtë e fituar me sakrificë dhe themel i barazisë mbi të cilën qëndron shteti multietik. Çdo tentativë për ta zbehur apo për ta përjashtuar atë përbën kthim prapa. Po aq shqetësuese është heshtja e koalicionit VLEN, i cili në vend se të mbrojë të drejtat e qytetarëve shqiptarë, zgjedh të bëjë spektatorin përballë një

tendence të rrezikshme për zhbërjen e standardeve të arritura. BDI rikujton se barazia gjuhësore nuk negociohet dhe nuk relativizohet. Ajo zbatohet. Çdo veprim ndryshe do të hasë në kundërshtimin tonë të vendosur institucional dhe politik. Gjuha shqipe nuk do të kthehet në zero. Ajo është pjesë e identitetit, e Kushtetutës dhe



e realitetit të pakthyeshëm të këtij shteti”, thuhet në reagimin e BDI-së.

KOMF-I KUNDËRSHTON PAGESËN DITORE PËR PËRCJELLËSIT E FËMIJËVE NË QKUK: BIE NDESH ME LIGJIN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF ka shprehur shqetësim lidhur me vendosjen e pagesës ditore për prindërit, kujdestarët ligjorë/përcjellësit e fëmijëve mbi 15 vjeç në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme. “Ky vendim bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 3, nënparagrafi 1.1, përcakton se: ‘Fëmijë – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të

cilit ai i nënshtrohet’. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës përkufizon ‘fëmijën’ si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç nëse sipas ligjit që i zbatohet atij, moshë madhore arrihet më herët. Po ashtu, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, Neni 7.4 përcakton që Fëmija ka të drejtë që, gjatë qëndrimit në institucionin shëndetësor me shtretër, ta ketë pranë prindin, përfaqësuesin ligjor ose të afërmin e përcaktuar nga ai ose nga përfaqësuesi ligjor”, është thënë në reagimin e KOMF-it, duke shtuar se për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes apo vendosja e barrës financiare për prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve nga moshë 15 deri në 18 vjeç është në



kundërshtim me përkufizimin ligjor të fëmijës në Republikën e Kosovës dhe cenon parimin themelor të interesit më të mirë të fëmijës. “Prania e prindit apo kujdestarit ligjor gjatë

hospitalizimit është nevojë thelbësore për mirëqenien emocionale, psikologjike dhe fizike të fëmijës. Një vendim i tillë shkel të drejtat e fëmijës, rrezikon të krijojë pengesa shtesë për

familjet dhe të ndikojë negativisht në qasjen e barabartë të fëmijëve në shërbime shëndetësore”, ka theksuar KOMF-i.

Për më tepër, KOMF-i vlerëson se në shumë raste prindërit apo kujdestarët ligjorë kryejnë një pjesë të punës mbështetëse brenda institucionit shëndetësor. “Ky kontribut duhet të njihet dhe të vlerësohet, e jo të sanksionohet përmes vendosjes së pagesës. KOMF i bën thirrje institucioneve përgjegjëse që të rishqyrtojnë këtë vendim dhe të harmonizojnë çdo akt administrativ me legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare, duke vendosur në qendër interesin më të mirë të fëmijës”, është thënë në reagimin e KOMF-it.

NGA 1 MARS 15 KATEGORI DO TË LEJOHEN TË UDHËTOJNË FALAS ME TRAFIK URBAN PËRMES KULETËS DIGJITALE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Nga data 1 mars 2026, të gjithë qytetarët që përfshihen në kategoritë e liruara nga pagesa në autobusët e NPK “Trafiku Urban” të Komunës së Prishtinës do të lejohen të udhëtojnë falas vetëm përmes Kuletës Digjitale. Kategoritë e liruara janë: Fëmijët deri në moshën 7 vjeç; Personat me aftësi të kufizuara; Rastet sociale; Veteranët me status “Veteran i Luftës së UÇK-së”; Invalidët e luftës së UÇK-së; Familjarët e dëshmorëve dhe të të zhdukurve të luftës së UÇK-



së; Pensionistët e Komunës së Prishtinës; Pjesëtarët e Forcës së

Sigurisë së Kosovës (FSK); Policia e Kosovës; Zjarrfikësit;

Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Prishtinës; Stafi shëndetësor, administrativ, teknik dhe mbështetës i të gjitha institucioneve komunale shëndetësore të kryeqytetit (niveli lokal); Stafi mësimor, administrativ, teknik dhe mbështetës i të gjitha institucioneve komunale arsimore të kryeqytetit, përfshirë institucionet parashkollore (niveli lokal); Të gjithë punonjësit e administratës komunale të Kryeqytetit; Të gjithë studentët e kryeqytetit. Për të përfutur nga ky privilegj, duhet të krijoni llogari në Kuletën Digjitale dhe të

ngarkoni dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë letërnjoftimin, fotografi dhe vërtetim nga institucioni përkatës. Pensionistët mbi 65 vjeç lirohen vetëm me kartë identiteti. Nxënësit, rastet sociale dhe personat me aftësi të kufizuara mund të përdorin Kuletën Digjitale ose kartelë fizike. Sipas njoftimit zyrtar, kjo masë synon lehtësimin e qasjes në transportin publik për kategoritë e përfituesve, duke e bërë procesin më transparent dhe të menaxhueshëm përmes përdorimit të teknologjisë digjitale.

Gazetarja Alketa Gashi-Fazliu nderohet me Çmimin Ndërkombëtar për Gazetari Etike në Romë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Gazetarja dhe prezantuesja e edicionit informativ në RTK, Alketa Gashi-Fazliu, është nderuar me Çmimin Ndërkombëtar për Gazetari Etike (Premio Internazionale di Giornalismo Etico), në një ceremoni të mbajtur në Ministrinë e Kulturës në Romë, ndërsa çmimi u nda nga shoqata ‘VerbumlandiArt APS’, me presidente Regina Resta dhe presidente të çmimit Incoronata

Boccia.

Ky çmim i është ndarë me motivacionin: “Për profesionalizmin, besueshmërinë dhe përkushtimin me të cilin ushtron rolin e gazetares dhe prezantuese së edicionit informativ të RTK-së së Kosovës, duke përfaqësuar një pikë referimi autoritative për informimin publik. Dallohet për qartësinë në paraqitje, balancën narrative dhe vëmendjen e vazhdueshme ndaj saktësisë së

burimeve, duke kontribuar në një komunikim të përgjegjshëm dhe të kuptueshëm edhe në kontekste më komplekse. Puna e saj forcon vlerën e shërbimit publik radioteleviziv dhe rolin e gazetarisë si një instrument thelbësor për transparencë, besim dhe kohezion demokratik”.

Alketa Gashi-Fazliu këtë çmim e ka vlerësuar si një nga ditët me të mira të jetës së saj.



Kusari-Lila siguron se bizneset prodhuese do të kenë mbështetjen e Ministrisë dhe Industrisë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila ka zhvilluar një takim me drejtorin e Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, me të cilin diskutuan për avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet MINTI-it dhe AKB-së.

Ministria theksoi se partneriteti ndër vite ka qenë i qëndrueshëm dhe produktiv. Ministria Kusari-Lila njoftoi se u dakorduan që komunikimi i përbashkët të intensifikohet edhe më tej, duke hapur rrugë për iniciativa të reja në mbështetjen e sektorit privat. Në takim bashkëbisedimi u

fokusua në fuqizimin e prodhuesve vendorë, zhvillimin e parqeve industriale dhe krijimin e kushteve më të favorshme për bizneset. Ministria siguroi se bizneset prodhuese do të kenë mbështetjen e plotë të MINTI-it në rugëtimin e tyre drejt rritjes dhe zhvillimit.



EKSPORTI NË MUAJIN JANAR MBULON IMPORTIN ME 14,1%

PRISHTINË, 25 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2026.

Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej -11,6 % në muajin janar 2026, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025, gjegjësisht në vlerë prej 365,9 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 414,1 milionë eurosh në vitin 2025. Eksporti mbulon importin me 14,1 %. Eksporti i mallrave në muajin janar 2026 kishte vlerën 60,2 milionë euro, ndërsa importi 426,1 milionë euro që është një rritje prej 0,8 % për eksport, si dhe një rënie prej 10,1 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 21,9 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11,9 % e

përbëjnë produktet minerale; 11,8 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,4 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9,0 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 7,6 % e përbëjnë tekstili dhe artikuj tekstili, etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 17,6 % e përbëjnë produktet minerale; 12,8% e përbëjnë mjetet e transportit; 11,4 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,4 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 8,1 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 19,0 milionë euro, ose rreth 31,6 % e



eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-15,6 %). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9,8 %), Italia (3,6 %) dhe Holanda (3,6 %), etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 162,5 milion e uro, ose 38,1% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-20,5 %). Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (13,7%), Italia

(3,8%), Polonia (3,6%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 27,0 milionë euro, ose 44,8 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 11,8 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (16,9 %),

Maqedonia e Veriut (15,9 %), Serbia (6,7 %), Mali i Zi (4,7 %), etj. Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 63,6 milionë euro, ose 14,9 % të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-23,9 %). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6,5 %), Maqedonia e Veriut (4,8 %), Serbia (2,4 %).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 14,2 milionë euro, ose 23,6 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (12,0 %) dhe Turqia (6,1 %).

Importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 200,0 milionë euro, ose 46,9 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (13,8 %) dhe Turqia (12,5 %).



RAFUNA PRET AMBASADOREN E KOSTA RIKËS, FLASIN PËR INVESTIMET

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në një takim zyrtar ambasadorën e Republikës së Kosta Rikës në Republikën e Kosovës, Olga M. Sauma Uribe. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë në promovimin e shkëmbimeve tregtare, organizimin e panairëve ndërkombëtare dhe krijimin e platformave B2B për lidhjen

direkte të bizneseve kosovare me ato nga Kosta Rika.

U theksua rëndësia e intensifikimit të komunikimit institucional dhe të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të biznesit, me synim identifikimin e sektorëve me potencial për investime dhe rritje të volumit tregtar.

Në shenjë respekti dhe vlerësimi për vizitën dhe gatishmërinë për bashkëpunim, kryetari Rafuna i ndau ambasadores një dhuratë simbolike.

Numri më i madh i përfituesve nga pensionet bazike të moshës

PRISHTINË, 25 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin janar 2026. Sipas të dhënave të muajit janar

2026, struktura e përfituesve nga skemat e mirëqenies sociale, kryesisht ka në fokus mbështetjen e të moshuarve, kategoritë e dala nga lufta dhe

familjet në nevojë.

Ndërkohë, skemat e tjera përfshijnë pensionet familjare, pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike, pensionet e

familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pensionet e Trepçës, si dhe skema të tjera specifike sociale.



GATI SULMI NDAJ IRANIT? TRE SKENARËT USHTARAKË QË MUND TË NDRYSHOJNË LINDJEN E MESME



Lindja e Mesme po hyn sërish në një moment kritik, ku diplomacia dhe fuqia ushtarake ecin paralelisht në një ekuilibër të brishtë. A është gati sulmi ndaj Iranit?

Ndërsa bisedimet mes Uashingtonit dhe Teheranit afrohen drejt një pike vendimtare, në horizont shfaqen aeroplanmbajtëset, avionët luftarakë dhe skenarët e përshkallëzimit që mund të riformatojnë arkitekturën e sigurisë rajonale. A jemi përballë një presioni të kalkuluar për marrëveshje, apo pragut të një përplasjeje që mund të ndryshojë balancat gjeopolitike në gjithë Lindjen e Mesme?

Pak orë përpara atij që me shumë gjasa do të jetë raundi i fundit i bisedimeve midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara, që do të mbahet në Gjenevë të enjten, forcat amerikane po përfundojnë dislokimin në teatrin e gjerë të Lindjes së Mesme.

Aeroplanmbajtësja “Ford” ndodhet në gjirin e Sudës, në Kretë, në pritje për t’u pozicionuar me shumë gjasë përballë brigjeve të Levantit, përflitet edhe një ndalesë në portin e Haifës, ndërsa ura ajrore mes SHBA-ve dhe bazave

në Lindjen e Mesme, përmes Evropës, vazhdon.

Pse bisedimet SHBA–Iran rrezikojnë të dështojnë

Sinjalet për një marrëveshje të mundshme janë jashtëzakonisht të dobëta, pavarësisht optimizmit iranian: ministri i Jashtëm Abbas Araghchi kishte deklaruar për CBS, në një intervistë të transmetuar të dielën, se kishte “mundësi të mira” për një zgjidhje diplomatike të çështjes bërthamore, duke shtuar se kjo ishte e vetmja temë në diskutim.

Mbështetja e Kinës dhe ndikimi në ekuilibrin ushtarak

Ndërkohë, Teherani po merr mbështetje nga Kina: përveç publikimit të imazheve satelitore të bazave amerikane në Lindjen e Mesme, njësoj si përpara sulmit të qershorit 2025, Republika Popullore ka dërguar në Gjirin Persik një shkatërrues të klasës Type 055 dhe anijen e saj më të avancuar spiune, Liaowang-1. Kjo anije është e pajisur për të monitoruar satelitët ushtarakë dhe për të gjurmuar lëshimet e raketave, duke shërbyer edhe si

qendër e lëvizshme komande dhe kontrolli për operacionet detare.

Mbi të gjitha, Pekini i ka dhënë Teheranit akses në sistemin e tij satelitor të navigimit BeiDou, pas braktisjes nga Irani të GPS-it amerikan. Besohet se Kina po i furnizon Iranit të dhëna inteligjence të dobishme në rast të një kundërsulmi.

Sot është bërë e ditur se Teherani është pranë finalizimit të një marrëveshjeje me Pekinin për blerjen e raketave kundëranije CM-302, megjithëse nuk është rënë dakord për një datë dorëzimi. Këto raketa supersonike kanë një rreze veprimi rreth 290 kilometra dhe janë projektuar për të shmangur mbrojtjet detare duke fluturuar në lartësi të ulët dhe me shpejtësi të lartë.

Dislokimi i tyre do të rriste ndjeshëm kapacitetet sulmuese të Iranit dhe do të përbënte kërcënim për forcat detare amerikane në rajon, por për momentin nuk ka tregues se dorëzimi është në proces.

Tre skenarët amerikanë

Në këtë kontekst politik dhe ushtarak, cilat do të ishin opsionet amerikane për një sulm ndaj Iranit?

Opsioni i parë do të ishte i natyrës jo-kinetike. SHBA, së bashku me Izraelin, mund të kryejnë sulme kibernetike për të nxjerrë jashtë funksionit objektiva ushtarake dhe civile, duke reduktuar kapacitetin mbrojtës dhe reagues iranian dhe duke goditur infrastrukturën kritike të Gardës së Revolucionit Islamik (pasdaranët), që menaxhojnë arsenalin raketor dhe programin bërthamor iranian.

Një tjetër mundësi jo-kinetike do të ishte përdorimi i armëve me radiofrekuencë ose mikrovalë për të degraduar apo shkatërruar mikroçipat në sistemet kyçe iraniane, natyrisht ato që nuk janë të mbrojtura, siç janë ato në bunkerë të thellë.

Duhet marrë në konsideratë edhe lufta e informacionit: SHBA mund të lehtësojnë hyrjen e më shumë terminalëve Starlink në Iran për të anashkaluar bllokimin e internetit nga regjimi dhe për të përhapur propagandë anti-regjim.



Opsioni i dytë, i përmendur edhe nga presidenti Donald Trump, do të përfshinte sulme ajrore të kufizuara ndaj objektivave me vlerë të lartë strategjike: infrastrukturë bërthamore, qendra komande dhe kontrolli të pasdaranëve, seli të forcave të armatosura dhe

depo të njohura raketash. Do të ishte një fushatë ajrore e kufizuar, dy ose tre ditore, që do të përdorte kryesisht sisteme stand-off si raketat “Tomahawk”, dronë sulmues dhe avionë F-35 me armatim me rreze të gjatë.

Opsioni i tretë, do të ishte një fushatë e gjatë dhe intensive ajrore, që do të përfshinte sulme për “dekapitimin” e udhëheqjes politike dhe ushtarake iraniane, shkatërrimin e të gjitha infrastrukturave të lidhura me programin bërthamor, dhe përpjekjen për të eliminuar sa më shumë arsenalin raketor iranian, duke goditur jo vetëm pozicionet e njohura të lëshimit dhe magazinimit, por edhe industrinë raketore iraniane.

Arsenali raketor iranian, pika kyçe e konfliktit

Çështja kryesore që ka bërë të dështojnë përpjekjet e mëparshme për marrëveshje pas përfundimit të JCPOA-s (marrëveshja bërthamore e epokës Obama) është pikërisht arsenalin e raketave balistike të Iranit, i cili përbën mjetin e vetëm realisht efektiv të parandalimit në duart e regjimit iranian. / bota.al



Zhegrova kthehet në Francë?

TORINO, 25 SHKURT - Futbollisti i Kosovës, Edon Zhegrova mund të kthehet të luajë sërish në Ligue 1 të Francës. “Mediafoot” i Italisë ka shkruar se Marseille

ka shprehur interesim për transferimin e Zhegrovës. “Marseille po planifikon riorganizim në sulm dhe po monitoron situata të caktuara

në Serie A. Rasti i Zhegrovës është veçanërisht i rëndësishëm”, ka shkruar mediumi italian. Zhegrova ka kontratë me Juventusin deri në

vitin 2030. Zhegrova më herët ka luajtur me sukses për Lillen. 26-vjeçari kaloi te Juventusi nga skuadra franceze vitin e kaluar.

CONFERENCE LEAGUE, DRITA SYNON PËRMBYSJEN NDAJ CELJES

GJILAN, 25 SHKURT - FC Drita do të zbresë sot (e enjte) në fushë për ndeshjen e kthimit të “play-off”-it të UEFA Europa Conference League ndaj NK Celje, në një duel vendimtar që zhvillohet në Slloveni. Takimi i parë, i luajtur në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, ka përfunduar me rezultat 2:3 në favor të

skuadrës sllovene, duke e lënë gjithçka të hapur për sfidën e kthimit. Drita synon përmbysjen historike për të siguruar fazën e 1/8, ndërsa Celje do të mundohet të ruajë epërsinë minimale të krijuar në kryeqytetin e Kosovës. Ndeshja Celje - Drita, do të luhet me fillim nga ora 18:45. Drejtësinë në këtë

ndeshje do ta ndajnë gjyqtarët nga Polonia, ku kryesori do të jetë Damian Sylwestrzak (Syllvestzhak). Ai do të asistohet nga Pawel Sokolnicki (Sokolniki) e Adam Karasewicz (Karaseviq), ndërsa gjyqtarë i katërt do të jetë Lukasz Kuzma. Në VAR, do të jetë Piotr Lasyk, kurse në AVAR është caktuar Pawel Malec.



HENDBOLL, KOSOVA PUBLIKON LISTËN PËR NDESHJET E MARSIT



PRISHTINË, 25 SHKURT - Selektori i Kosovës, Agron Shabani, e ka shpallur të mërkurën listën e hendbollisteve të ftuara për ndeshjet me Finlandën. Në kuadër të fazës së dytë dhe të fundit kualifikuese për Kampionatin Evropian 2026, Kosova i luan në fillim të marsit dy ndeshje me Finlandën. Ndeshja e parë është më 5 mars

nga ora 17:30 në Vantaa të Finlandës, ndërsa e dyta më 8 mars nga ora 17:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Grumbullimi i Kosovës bëhet të dielën në Prishtinë, ndërsa të mërkurën e javës së ardhshme është udhëtimi për në Finlandë. Selektori Shabani ka ftuar 16 lojtare për këtë grumbullim, ku në kombëtare

janë kthyer Dafina Mustafa, Yllka Shatri e Melisa Mulaj. Kosova i ka luajtur tashmë dy ndeshje në këto kualifikime, ku është mposhtur nga Franca dhe Kroacia. Dy humbje i ka edhe Finlanda, kështu që ndeshjet e marsit pritet të vendosin për vendin e tretë në grup, prej të cilit është i mundshëm kualifikimi në Evropian.

FENERBAHÇE NUK HEQ DORË NGA MURIQI

Stamboll, 25 shkurt – Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi po kalon formë jetësore te Mallorca, skuadër kjo që po ka telashe të mëdha në La Liga të Spanjës. Me gjithë 16 golat e tij, Mallorca është vetëm e 18-a në tabelë, pozitë kjo që në fund dërgon në kategorinë e dytë. Mirëpo, gjasat që Muriqi të luajë në kategorinë e dytë janë

fare të vogla pasi mediumet në Turqi kanë raportuar se Fenerbahçe po e monitoron me kujdes situatën e sulmuesit të Kosovës. Nëse Mallorca bie nga liga, atëherë nuk do të ketë pengesa që sulmuesi 31-vjeçar të kthehet te gjiganti turk. Ndërkohë, nëse Mallorca mbetet në La Liga, Fenerbahçe do të tentojë ta shfrytëzojë

dëshirën e Muriqit për kthim në Stamboll për të siguruar shërbimet e tij. Fenerbahçe e ka synuar Muriqin edhe në afatin kalimtar të janarit, por Mallorca ka refuzuar ta lirojë atë. Muriqi për Fenerbahçen kishte luajtur vetëm në sezonin 2019/2020, duke realizuar 15 gola e pesë asistime në 32 paraqitje kampionale.



Allegri shqyrton të ardhmen e tij te Milani

Milan, 25 shkurt - Trajneri i Milanit, Massimiliano Allegri është duke shqyrtuar të ardhmen e tij në klub përtej verës pasi është i pakënaqur me tregun e transferimeve dhe me menaxhimin. “Sportitalia” ka raportuar se e ardhmja e Allegrit në Milan është e pasigurt, pasi trajner po

vlerëson të ardhmen e tij në klub. Sipas raportit, ka shumë arsye pas shqetësimit të Allegrit, duke përfshirë konfuzionin brenda klubit dhe afatet e pakënaqshme të transferimeve. Redaktori i “Sportitalia”, Michele Criscitiello, ka pohuar se

marrëdhënia midis Allegrit dhe Milanit ka arritur në një nivel të ri të ulët pas rezultateve zhgënjyese kundër Comos dhe Parmës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që trajneri ka vendosur të largohet nga klubi. Allegri është thënë se do të bëjë vlerësimet e tij në muajt në vijim përpara se

të vendosë nëse do të vazhdojë përtej verës. Trajneri italian ka kontratë me kuqezinjët deri në qershor të vitit 2027, por marrëveshja përfshin një mundësi për ta zgjatur atë për një sezon të mëtejshëm. Milani renditet i dyti në tabelën e Serie A, 10 pikë pas rivalëve të tyre të qytetit, Interit.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REBUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA FERIZAJT – OPSTINA UROSEVAC – MUNICIPALITY OF FERIZAJ
NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ SH.A.



Mbështetur në dispozitat e nenit 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 13 të ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , neni 183 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqërit tregtare , të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale “ Stacioni i Autobusëve “ Sh.a. Bordi i Drejtorëve i N.P.L. “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a. në Ferizaj shpall :

Më :25.02.2026

K O N K U R S

1.Kryeshef Ekzekutiv të N.P.L. “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a. (1)

Përshkrimi i detyrave dhe Përgjegjësi

1. Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet për të lidhur kontrata, në pajtueshmëri me ligjin , aktet tjera nënligjore dhe me Statutin e Ndërmarrjes N.P.L. “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a. duke i'u nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve ,
2. Biznesi , detyrat dhe organizimi i Ndërmarrjes duhet të kryhet sipas direktivave , mbikëqyrjes dhe përgjegjësi të Kryeshefit Ekzekutiv në pajtueshmëri me Statutin e Ndërmarrjes NPL “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a.dhe akteve tjera nënligjore të ndërmarrjes dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve ,
3. Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e ndërmarrjes të cilat nuk janë përgjegjësi e Bordit të Drejtorëve , Komisionit të Auditimit , do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësi të Kryeshefit Ekzekutiv ,
4. Kryeshefi Ekzekutiv ka autoritet të punësoj apo të largoj nga puna stafin e ndërmarrjes , përveç atyre që janë kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve ,
5. Kryeshefi Ekzekutiv këshillon dhe asiston bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë dhe planeve strategjike afatgjata,
6. I dorëzon sipas pozitës së tij dhe përgjegjësi të Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve që parashikohen sipas Ligjit per Ndermarrjet Publike ,
7. I ofron kurdo që është e nevojshme dhe së paku një (1) here ne tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksione kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të nxjerra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve te ndermarrjes ,
8. I dorëzon , nën përgjegjësinë e tij , Bordit të Drejtorëve , dokumente , letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve ,
9. Themelon dhe rishikon hierarkinë dhe strukturën organizative të ndërmarrjes ,
10. Të marr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme ,

MANDATI : Kryeshefi Ekzekutiv zgjidhet me mandate 3 vjeçar .

PAGA : Në pajtim me politikën e kompenzimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

KUALIFIKIMI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17,3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , kandidatët për tu zgjedhur Kryeshef Ekzekuiv , duhet të plotësojnë këto kushte :

- Të ketë përgatitje universitare ,
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhim ,
- Të posedojë aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në mënyrë të sukseshme në një shoqëri multi etnike ,
- Të ketë aftësi për të kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion ,

KUSHTET

- Kandidatët të cilët do të përzgjidhen në pozitën e lartcekur në N.P.L. “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ sh.a. duhet :
- Të mos jenë të denuar dhe nën hetime ,
 - Të mos kenë bërë shkelje të Kodit të Etikës për standard dhe sjellje profesionale.

KUSHTET PËR APLIKIM

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L. “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ sh.a. në Ferizaj duhet ti dorëzojnë këto dokumente :

- Dëshmine për kualifikimin profesional ,
- CV-në
- Letër motivimi ,
- Dëshminë për përvojën e punës
- Çertifikatën e lindjes ,
- Çertifikatën që nuk është nën hetime ,
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit te dokumentacionit)

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim , në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit , pavarësinë dhe përgatitjen profesionale , çdo përgënjeshttrim material , qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur , do te rezultoj me diskualifikim te menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet te jetë në zarf i mbyllur dhe të dorëzohen në zyrat e Ndërmarrjes Publike Lokale “ STACIONI I AUTOBUSËVE” sh.a. në Ferizaj

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data 25.02.2026 deri më 11.03.2026 ,në ora 16: 00.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Flamurtar Ukaj B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues” 810026288 të lëshuar nga ARBK. shme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë të gjimnazit “Frang Bardhi”. Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.
- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507. Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”. Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fehmi Rama” ish shkolla fillore “Emin Duraku” Likoc Skenderaj. - Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Azem Bejta” Prekaz i Eperm Skenderaj. - Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Rustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Trepça” Stanterg. - Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Malush Ahmeti” ish shkolla “Muharrem Bekteshi” Rezalle Skenderaj. Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme



REPUBLIKA E KOSOVËS – REBUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA FERIZAJT – OPSTINA UROSEVAC – MUNICIPALITY OF FERIZAJ
NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “ STACIONI I AUTOBUSËVE ” SH.A.



U skladu sa odredbama člana 21. Zakona br.03 / L-087 o javnim preduzećima, člana 13 Zakona br.04 / L-111 o izmenama i dopunama Zakona br.03 / L-087 o javnim preduzećima, član 183 Zakon br. 02 / L-123 o trgovinskim društvima, Statut lokalnog javnog preduzeća "Autobuska stanica" a.d. Odbor direktora L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu objavljuje:

Datum: 25.02.2026

K O N K U R S

1. Izvršni načelnik L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. (1)

Opis zadataka i odgovornosti

1. Izvršni načelnik ima ovlašćenje da zaključi ugovore, u skladu sa zakonom, i druge podzakonske akte i Statut preduzeća L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. poštujući samo ograničenja utvrđena od strane Odbora direktora,
2. Biznis, zadaci i organizacija preduzeća mora se izvršiti u skladu sa smernicama, nadzor i odgovornosti generalnog direktora u skladu sa Statutom L.J.P. preduzeća "Autobuska stanica" A.D. i drugih akata preduzeća i odlukama Upravnog odbora,
3. Sva pitanja koja se odnose na poslovanje kompanije koja nisu u nadležnosti Upravnog odbora, Komisije za reviziju, će biti uspostavljena od strane ili u skladu sa smernicama i odgovornosti izvršnog načelnika,
4. Izvršni načelnik ima ovlašćenje da zapošljava ili razrešava osoblje preduzeća, osim onih koje su isključiva nadležnost Odbora direktora,
5. Izvršni načelnik savetuje i pomaže Upravnom odboru u definisanju dugoročne strategije i strateških planova,
6. Podnosi, prema svojoj poziciji i odgovornosti odbora direktora, nacrt dokumente predviđene Zakonom o javnim preduzećima,
7. Pruža kad god je to potrebno, a najmanje jedan (1) na svaka tri meseca, Upravnom odboru izveštaja o velikim transakcijama od strane kompanije i glavne odluke koje su donete od strane rukovodstva u vezi sa poslovnim rukovodstvom i radi na preduzeće,
8. Pod svojom odgovornošću podnosi odboru direktora, dokumente, dopise i informacije o svim pitanjima koja su uključena u dnevni red sastanaka,
9. Uspostavlja i revidira hijerarhiju i organizacionu strukturu preduzeća,
10. Da prisustvuje svim generalnim sastancima,

MANDAT: Izvršni načelnik se bira sa mandatom od 3 godine.

PLACTA: U skladu sa politikom kompenzacije koju odobrava Odbor direktora.

KVALIFIKACIJA I PROFESIONALNA PRIPREMA

U skladu sa članom 17. stav 17.3 Zakona 03 / L-087 o javnim preduzećima kandidati da bi bili izabrani za izvršni načelnik, moraju ispunjavati sledeće uslove:

- Da imaju univerzitetsku pripremu,
- Imati najmanje 5 godina iskustva menadžmenta,
- posedovati profesionalne veštine i veštine za uspešno delovanje u multietničkom društvu,
- Da ima sposobnost obavljanja radnih zadataka u mirnoj situaciji i pod pritiskom,

USLOVI

- Kandidati koji će biti izabrani na pomenutoj poziciji u L.J.P "Autobuska stanica" a. d. treba:
- da ne budu osuđeni i pod istragom,
 - da nisu prekršili etički kodeks za standardne i profesionalno ponašanje.

USLOVI ZA APLICIRANJE

Kandidati za izvršnog načelnika u L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu treba dostaviti ove dokumente:

- Certifikat o profesionalnoj kvalifikaciji,
- Biografiju
- Pismo motivacije,
- Dokaz radnog iskustva
- Izvod rođenja,
- Certifikat da nije pod istragom,
- Izjava pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije).

Podnosilac aplikacije mora pripremiti izjavu pod zakletvom da on / ona ima adekvatnu kvalifikaciju, nezavisnost i stručnu spremu, nikakvu materijalnu lažno predstavljanje, da li je to namerno ili iz nehata ili materijalne promene u informacijama pomenutih u gornjoj izjavi, rezultirati u neposrednoj diskvalifikaciji.

Dokumentacija mora biti u zapečaćenom kovertu i dostavljena u kancelarije Lokalnog javnog preduzeća "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu

Rok za prijavu je otvoren 15 dana od 25.02.2026. Do 11.03.2026. u 16:00 časova.



Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Ermali” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/6819/MMPHI/557/DMM, për veprimtarinë: Shfrytëzim i rërës dhe zhavorit, Shishman i Bokës, Gjakovë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 25.03.2025, në ora: 10:30, në hapësirat e Cati Restaurant, Shishman, Gjakovë, do të organizohet debat publik nga operatori “Ermali” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/6819/MMPHI/557/DMM, për veprimtarinë: Shfrytëzim i rërës dhe zhavorit, Shishman i Bokës, Gjakovë, me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>
Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=ermali>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
“Ermali” Sh.p.k.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën paragrafi 2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar me datë 26.02.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 008/26 të datës 23.02.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A. me datë 24.02.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli: Recepsionist - Roje
- Numri i ekzekutuesve: 1
- Orët e punës: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
- Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme apo fillore
- Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
- I raporton: Udhëheqësit të Njësise së Recepsionistëve - Rojeve
- Koeficienti i pagës: 434.78 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Regjistron vizitorët dhe mban evidencën për hyrjet dhe daljet në objekt, dhe në të njëjtën kohë ruan pasurinë e objektit të ruan.
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent.
- Kontrollim i bagazheve ose sendeve të dyshimta.
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në vend tjetër për recepsion - roje.
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë.
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit.
- Ka qasje në kamerat e sigurisë në bazë të pëlqimit paraprak të institucionit.
- Në raste të zjarrit, evakuimit ose kërkimeve të tjera, udhëzon njerëzit për të zbatuar protokollin e sigurisë.
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësise së Recepsionistëve – Rojeve.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të udhëzimeve nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar).

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjërat e zotëruara në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Periodha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 25.02.2026 deri me datë 11.03.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.03.2026 deri me datë 23.03.2026.
- Shqyrtimi i ankesave për verifikim paraprak më së largu deri me datë 30.03.2026.

- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 08.04.2026.
- Afati për ankesë nga data 11.04.2026 deri me datë 14.04.2026
- Shqyrtimi i ankesave të testit me shkrim më së largu deri me datë 20.04.2026.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 27.04.2026.
- Afati për ankesë nga data 28.04.2026 deri me datë 30.04.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 08.05.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfaqësojnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtrri, fron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinjtë më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 25.02.2026 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-26-01

Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes:	25.02.2026
Sqarimi:	deri me 12.03.2026
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 12.03.2026 Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit:	12.03.2026 në 11:00
Vendi i dorëzimit:	Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.

Për më shumë detaje lidhur me këtë shpallje, ju lutemi vizitoni www.trepcash.com ose na kontaktoni në adresat e mëposhtme.

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial, Mitrovicë 40000		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Republika e Kosovës
Kontakti: sales@trepcash.com		Telefoni: +383 (0) 28 538 050 Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcash.com		



U prilog članu 8. članu 10 pod stav 1. člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.10.2010. u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, člana 18 i člana 22 Urednika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donjetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përpلامي" Sh. A na osnovu rješenja br. protokola 608/26 od 23.02.2026.godine glavnog izvršnog direktora N.P.L. "Përpلامي" Sh. A od 24.02.2026. godine štava.

JAVNI KONKURS

- I. Naslov: Recepcioner – Čuvár
- Broj izvršilaca: 1
- Radno vrijeme: 40 sati sedmično
- Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
- Stručna priprema: Srednja ili osnovna škola
- Radno iskustvo: Poželjno šest (6) meseci
- Izveštava: Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara
- Koeficijent plate: 390.00 Euro brutto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sposobnost za obavljanje posla u punom radnom vremenu bez ograničenja;
- Evidentira posetioce i vodi evidenciju o ulascima i izlascima iz objekta, istovremeno čuva imovinu objekta koji obzbeđuje;
- U slučaju opasnosti odmah obavestiti nadležne osobe;
- Kontroliše prtljag i sumnjive predmete;
- Po potrebi može biti raspoređen i na drugo mesto za recepciju – čuvara;
- Obavezan je koristiti sva propisana sredstva za zaštitu na radu;
- Mora znati koristiti protivpožarna sredstva;
- Ima pristup sigurnosnim kamerama i potrebnu saglasnost institucije;
- U slučaju požara, evakuacije ili drugih pretnji, upućuje ljude da prate protokole bezbednosti;
- Odgovara za svoj rad Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara;
- Obavlja i druge zadatke po nalogu nadležnata preduzeća.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Përpلامي" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosova;
- Imaju puni kapacitet za djelovanje;
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova;
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova;
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti;
- Lekarsko uverenje;

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 25.02.2026 do 11.03.2026 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 18.03.2026.
- Rok za žalbu je od 19.03.2026 do 23.03.2026.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 08.04.2026.
- Rok za žalbu je od 11.04.2026 do 14.04.2026.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 27.04.2026.

- Rok za žalbu je od 28.04.2026 do 30.04.2026.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspešnog kandidata najkasnije do 08.05.2026.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L. "Përpلامي" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvićae se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Objašnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reći i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Përpلامي" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevezin ke zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiću da se prijave.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin "Reze Company" Sh.p.k. Marinë, Skenderaj, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/8571/MMPHI/753/DMM për veprimtarinë: Fabrikë e prodhimit të styroporit në Polac i Ri, Skenderaj,, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 19.03.2026, në ora: 12:00, në hapësirat e Reze Company sh.p.k., do të organizohet debat publik nga operatori "Reze Company" Sh.p.k. Marinë, Skenderaj, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/8571/MMPHI/753/DMM për veprimtarinë: Fabrikë e prodhimit të styroporit në Polac i Ri, Skenderaj, me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us05web.zoom.us/j/8055440459?pwd=qyEv4PmKJazwy1askLn5WHtYdINYN.1>
MeetingID : 890 5544 0459
Passcode : Lw ZJ0H

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=rreze>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"Reze Company" Sh.p.k.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L